



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr.1126/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paqarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.P “Fidani L”-Deçan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “BEJTA COMMERCE SH.A.; N.P.SH. “Eltoni Com” & “EUROCOM” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”, më datën: 01.02.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

I. **APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.T.P “Fidani L”-Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”.

II. **ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”. dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T.P “Fidani L”-Deçan, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.T.P “Fidani L”-Deçan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.12.2020 me nr. 1126/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 7, 24 pika 2, 51, 56, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 31.12.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Ekspertja Shqyrtuese fillimisht sqaron, se ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datë 24.04.2020 me Njoftimin për Kontratë, ku hapja e ofertave është bërë me datë 18.05.2020 dhe me datë 28.05.2020 AK ka rekomanduar për kontratë COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. “EltoniCom” & “Eurocom” Sh.p.k, mirëpo pas ankesave dhe vendimit të PSH 370/20 dt. 09.07.2020 ky aktivitet është kthyer në rivlerësim. Me datë 23.07.2020 AK gjatë procesit të rivlerësimit rekomandon po të njëjtin GOE COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. “Eltoni Com” & “Eurocom” Sh.p.k, përderisa prapë me shqyrtimin e ankesës në OSHP, PSH 550/20 dt 28.09.2020 ky aktivitet është obliguar që të kthehet prapë në rivlerësim, gjersa me datë 08.12.2020 gjatë procesit të rivlerësimit AK ka rekomanduar prapë

GOE të lartë përmendur, përderisa OE ankuesi “Fidani L” NTP pretendon se GOE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tyre mungojnë: Dokumentet të cilat i mungojnë konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A; N.P.SH. “Eltoni Com”; “Euro com” Sh.p.k.janë: Kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. “Eltoni Com” -Deklaratat Nën Betim të paraqitura në dosjen e tenderit nuk janë të marra nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe nr. i prokurimit Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimeve të lartpërmendura PSH nr 550/20 dt:28.09.2020 ka sqaruar:

dokumentet e konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës “Company Bejta Commerce Sh.A”; N.P.SH. “Eltoni Com”; “Eurocom” Sh.p.k., ku Company Bejta Commerce Sh.A. është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës e shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. “Eltoni Com” dhe deklaratat nën betim të paraqitur në dosje të tenderit nuk janë marrë nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe numri i projektit.

Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se OE Eltoni me datë 15.07.2020 i është drejtuar KRPP-së për interpretim me titull “Kërkesë për interpretim të lidhur me Aneksin 2-Deklarata nën Betim dhe Marrëveshjen e Konzorciumit”. Kurse, me datë 29.07.2020 KRPP-ja i kthen përgjigje duke dhënë sqarime lidhur me par. 4 të nenit 59 të LPP-së, 47.19 dhe 47.21 të RRUOPP-së, Konkretisht, KRPP-ja i jep këtë sqarim anëtarit të konsorciumit: “edhe pse për KRPP-ën një gabim i tillë do të konsiderohej devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale të dosjes së tenderit, megjithatë sipas paragrafit të lartë cituar Autoriteti Kontraktues duhet të vendos vet se çështja në fjalë a mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, Pra ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

D.m.th. KRPP e ka lënë në diskrecion të AK-së. Pretendimi i radhës nga OE ankuesi për të rekomanduarin: Inxhinierit si Izajdin Sylaj Gjeodezi, është Gjeodet te cilit i ka skaduar Licenca. Ju mungojnë kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT nga AK Komuna e Gjakovë. Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimeve sqaron se, ka një vendim të PSH 550/20 dt.28.09.2020:

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Berisha Com” sh.p.k – Gjakovë se gjeodetit Izajdin Sylaj i ka skaduar licenca, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK duhet që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së që të konfirmoj nëse i njëjti ka licence valide. Sa i përket pretendimit se OE të rekomanduar i mungojnë kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT nga AK, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është i bazuar dhe se AK duhet të kërkoj sqarime nëse i njëjti posedon këto kontrata konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, sa i përket Licencës po ashtu AK në Njoftimin për kontratë nuk ka cekur se kërkohet Licenca valide, andaj pretendimi nuk gjendet i bazuar. Ndërsa sa i përket kontratave të punëtorëve, GOE i rekomanduar ka bashkangjitur kontratat e punëtorëve në E-prokurim me datë 30.11.2020, dhe shihet se kontratat janë valide dhe vërtetohet se këto kontrata kanë qenë para hapjes si dhe nuk paraqesin ndryshim material konform LPP-së dhe Rruopp-së, sepse nuk janë kontrata mbi vepër por janë kontrata pune me kohë të caktuar/pacaktuar të nënshkruara kryesisht para hapjes e cila është e dëshmuar edhe me listën e ATK-së.

Pretendimi i fundit nga OE ankuesi për të rekomanduarin:

Ky konzorcium ka mungesë edhe tek makineritë si:

- o 1 Lug Ngarkues Mungon.

- o Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrim;

- o Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrim;

- o Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshën e kërkuar në dosjen e tenderit;

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimet e fundit sqaron se, për pretendimet e njëjta është një vendim i PSH 370/20 dt 09.07.2020.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE te rekomanduar për dhëni te kontratës ka mungesë edhe tek makineritë si: • 1 Lug Ngarkues Mungon. Paneli shqyrtues konform Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimi është i bazuar pretendimin për faktin se pajisja • Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrim, • Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrim. Paneli shqyrtues konstaton se ne baze te provave te ofruara vërtetohet se regjistrimi makinerisë ju ka skaduar para aplikimit, andaj ne pajtim me nenin 59.4 dhe 72 te LPP-se AK ka mundur te kërkoj sqarime për këto dëshmi.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshën e kërkuar në Dosjen e Tenderit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit ne këtë pike është i bazuar sepse duke u bazuar në kërkesën e AK-së tek FDT pika 9.1& 9.2 FDT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale 9.1&9.2-eshte kërkuar nje rimorkio deri në 40 ton), ndërsa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofruar librezë shihet që pesha e makinës se cekur si me lart është 80000 .

Si përfundim, Ekspertja Shqyrtuese i rekomandon AK-së, që procesin e rivlerësimit ta bëjë konform LPP-së dhe Rruopp-së, duke respektuar vendimet e OSHP-së 370/20 dhe 550/20, gjithashtu sa i përket

makinerisë sipas pretendimit të fundit për GOE të rekomanduarin, AK të verifikoj dhe analizoj se a i përmbushin kriteret sipas FDT-së pasi që në ofertën e GOE të rekomanduarit ka më tepër makineri të ofruara se sa që kërkohet nga AK, andaj AK të përqendrohet tek kërkesa sipas FDT-së. Po ashtu në raport të rivlerësimit të bëjë sqarimin e qartë me rastin e eliminimit dhe përzgjedhjes së Ofertuesve, pasi që AK në kërkesat për rishqyrtim të OE ankuesit nuk ka dhënë sqarimet e detajuara dhe përgjigje në pretendimet, me qëllim që ofertuesit/ankuesit të mirëkuptojnë vendimin e AK-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht, vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues nuk ka përgjigje.

Operatori ekonomik nuk ka përgjigje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.01.2021, përmes platformës Zoom ku prezent kane qene Paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-se, eksperti shqyrtues profesional i prokurimit ku : Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës në ora 10:00, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së si dhe eksperti shqyrtues Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën..

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankues z. Durim Beqiraj i cili deklaroi: se OE N.T.P “Fidani L”-Deçan qëndron prapa ankesës, bazuar ne raportin e ekspertit shqyrtues i propozojmë OSHP-së qe vendimi i Autoriteti Kontraktues te anulohet dhe te aprovohet ankesa jone si e bazuar.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Faton Gutaj i cili deklaroi se: Autoriteti Kontraktues qëndron prapa vendimit te vet .

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Blerina Huruglica: është hera e 3- të që ka ankesë për të njëjtin Aktivitet, tri ankesat pothuajse kanë qenë të njëjta me pretendime të njëjta arsyeja pse unë

kamë thënë që të aprovohet pjesërisht e bazuar. Ankesa dhe lënda të kthehet në rivlerësim është shkaku i makinerive.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurës sqaron si në vijim:

Paneli shqyrtues konform ekspertës Shqyrtuese fillimisht sqaron, se ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datë 24.04.2020 me Njoftimin për Kontratë, ku hapja e ofertave është bërë me datë 18.05.2020 dhe me datë 28.05.2020 AK ka rekomanduar për kontratë COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, mirëpo pas ankesave dhe vendimit të PSH 370/20 dt. 09.07.2020 ky aktivitet është kthyer në rivlerësim. Me datë 23.07.2020 AK gjatë procesit të rivlerësimit rekomandon po të njëjtin GOE COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "EltoniCom" & "Eurocom" Sh.p.k, përderisa prapë me shqyrtimin e ankesës në OSHP, PSH 550/20 dt 28.09.2020 ky aktivitet është obliguar që të kthehet prapë në rivlerësim, gjersa me datë 08.12.2020 gjatë procesit të rivlerësimit AK ka rekomanduar prapë GOE të lartë përmendur, përderisa OE ankuesi "Fidani L" NTP pretendon se GOE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tyre mungojnë: Dokumentet të cilat i mungojnë konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A; N.P.SH. "Eltoni Com"; "Euro com" Sh.p.k.janë: Kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. "Eltoni Com" -Deklaratat Nën Betim të paraqitura në dosjen e tenderit nuk janë të marra nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe nr. i prokurimit Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimeve të lartpërmendura PSH nr 550/20 dt:28.09.2020 ka sqaruar:

dokumentet e konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës “Company Bejta Commerce Sh.A”; N.P.SH. “Eltoni Com”; “Eurocom” Sh.p.k., ku Company Bejta Commerce Sh.A. është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës e shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. “Eltoni Com” dhe deklaratat nën betim të paraqitur në dosje të tenderit nuk janë marrë nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe numri i projektit.

Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se OE Eltoni me datë 15.07.2020 i është drejtuar KRPP-së për interpretim me titull “Kërkesë për interpretim të lidhur me Aneksin 2-Deklarata nën Betim dhe Marrëveshjen e Konzorciumit”. Kurse, me datë 29.07.2020 KRPP-ja i kthen përgjigje duke dhënë sqarime lidhur me par. 4 të nenit 59 të LPP-së, 47.19 dhe 47.21 të RRUOPP-së, Konkretisht, KRPP-ja i jep këtë sqarim anëtarit të konsorciumit: “edhe pse për KRPP-ën një gabim i tillë do të konsiderohej devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale të dosjes së tenderit, megjithatë sipas paragrafit të lartë cituar Autoriteti Kontraktues duhet të vendos vet se çështja në fjalë a mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, Pra ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

D.m.th. KRPP e ka lënë në diskrecion të AK-së. Pretendimi i radhës nga OE ankuesi për të rekomanduarin: Inxhinierit si Izajdin Sylaj Gjeodezi, është Gjeodeti të cilit i ka skaduar Licenca. Ju mungojnë kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT nga AK Komuna e Gjakovë. Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimeve sqaron se, ka një vendim të PSH 550/20 dt.28.09.2020:

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Berisha Com” sh.p.k – Gjakovë se gjeodetit Izajdin Sylaj i ka skaduar licenca, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK duhet që të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së që të konfirmoj nëse i njëjti ka licence valide. Sa i përket pretendimit se OE të rekomanduar i mungojnë kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT nga AK, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është i bazuar dhe se AK duhet të kërkojë sqarime nëse i njëjti posedon këto kontrata konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertës Shqyrtuese sqaron se: sa i përket Licencës po ashtu AK në Njoftimin për kontratë nuk ka cekur se kërkohet Licenca valide, andaj pretendimi nuk gjendet i bazuar. Ndërsa sa i përket kontratave të punëtorëve, GOE i rekomanduar ka bashkangjitur kontratat e punëtorëve në E-prokurim me datë 30.11.2020, dhe shihet se kontratat janë valide dhe vërtetohet se këto kontrata kanë qenë para hapjes si dhe nuk paraqesin ndryshim material konform LPP-së dhe Rruopp-së, sepse nuk janë kontrata mbi vepër por janë kontrata pune me kohë të caktuar/pacaktuar të nënshkruara kryesisht para hapjes e cila është e dëshmuar edhe me listën e ATK-së.

Pretendimi i fundit nga OE ankuesi për të rekomanduarin:

Ky konzorcium ka mungesë edhe tek makineritë si:

o 1 Lug Ngarkues Mungon.

o Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrim;

o Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrim;

o Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshën e kërkuar në dosjen e tenderit;

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimet e fundit sqaron se, për pretendimet e njëjta është një vendim i PSH 370/20 dt 09.07.2020.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE të rekomanduar për dhëni të kontratës ka mungesë edhe tek makineritë si: • 1 Lug Ngarkues Mungon. Paneli shqyrtues konform Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimi është i bazuar pretendimin për faktin se pajisja • Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrim, • Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrim. Paneli shqyrtues konstaton se në bazë të provave të ofruara vërtetohet se regjistrimi makinerisë ju ka skaduar para aplikimit, andaj në pajtim me nenin 59.4 dhe 72 të LPP-se AK ka mundur të kërkojë sqarime për këto dëshmi.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshën e kërkuar në Dosjen e Tenderit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit në këtë pikë është i bazuar sepse duke u bazuar në kërkesën e AK-së tek FDT pika 9.1& 9.2 FDT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale 9.1&9.2-është kërkuar një rimorkio deri në 40 ton), ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar librezë shihet që pesha e makinës së cekur si më lart është 80000.

Si përfundim, Paneli shqyrtues konform ekspertës Shqyrtuese i rekomandon AK-së, që procesin e rivlerësimit ta bëjë konform LPP-së dhe Rruopp-së, duke respektuar vendimet e OSHP-së 370/20 dhe 550/20, gjithashtu sa i përket makinerisë sipas pretendimit të fundit për GOE të rekomanduarin, AK të verifikojë dhe analizojë se a i përmbushin kriteret sipas FDT-së pasi që në ofertën e GOE të rekomanduarit ka më tepër makineri të ofruara se sa që kërkohet nga AK, andaj AK të përqendrohet tek kërkesa sipas FDT-së. Po ashtu në raport të rivlerësimit të bëjë sqarimin e qartë me rastin e eliminimit dhe përzgjedhjes së Ofertuesve, pasi që AK në kërkesat për rishqyrtim të OE ankuesit nuk ka dhënë sqarimet e detajuara dhe përgjigje në pretendimet, me qëllim që ofertuesit/ankuesit të mirëkuptojnë vendimin e AK-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë vlerësimin dhe ekzaminimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e FDT-së, duke mos vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të bëjë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e FDT-së, si dhe të veprojë në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Po ashtu, obligohet AK që në raportin e rivlerësimit të bëjë sqarimin e qartë me rastin e eliminimit dhe përzgjedhjes së ofertuesve, pasi që AK në kërkesat për rishqyrtim të OE ankuesit nuk ka dhënë sqarimet e detajuara dhe përgjigje në pretendimet, me qëllim që ofertuesit/ankuesit të kuptojnë vendimin e AK-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK "KK Gjakovë";

1x1 OE- "Fidani L"NTP;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.